



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datën 11.12.2014 Avokati i Popullit-Mekanizmi parandalues Nacional (MPN) realizoi **vizitë të rregullt të paparalajmëruar në SP Kisella Vodë** (vizitë e tretë nga ana e ekipit të MPN-së në këtë Stacion Policor). MPN-ja realizoi vizitën i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm i Shoqatës për të drejtën penale dhe kriminologji, në bazë të Memorandumit të kontraktuar paraprakisht për bashkëpunim.

MPN-ja realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin policor Kisella Vodë konform qëllimit të përcaktuar në Protokollin Fakultativ të Konventës kundër torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues. Me Protokollin Fakultativ është definuar se qëllimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria është identifikimi i rreziqeve në mënyrë që të parandalohet tortura ose llojet tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues.

Vizita e Stacionit Policor u realizua në mënyrë që fillimisht u realizua biseda me personin e ndaluar në stacionin policor, ndërkaq mëpas ekipi i MPN-së realizoi inspektim në vendet për ndalim të personave të privuar nga liria. Vizitën e vazhduam duke inspektuar një pjesë të ambienteve të tjera zyrtare dhe ndihmëse të SP Kisella Vodë.

Për momentin e vizitës së SP Kisella Vodë kishte një person të ndaluar me të cilin MPN-ja realizoi bisedë lidhur me trajtimin nga nëpunësit policorë dhe kushtet për ndalim në stacionin policor. Personi i ndaluar theksoi se gjatë arrestimit ishin shfrytëzuar mjete për lidhje (pranga) dhe u ankua për sjelljen gjatë arrestimit. Për sjelljen e nëpunësve policorë në SP Kisella Vodë theksoi se është profesionale dhe korrekte, ndërkaq kujdes të veçantë ka treguar përgjegjësi i turnit i cili ka qenë i obliguar për të, në raste kur ka nevojë për tualet ose ndonjë tjetër nevojë (sepse sistemi për thirrje nuk punon, për nevojë të caktuar ka informuar përgjegjësin e turnit duke bërë me shenjë para kamerës).

Personi i mbajtur u ankua lidhur me temperaturën në ambientin për vendosje, që u vërtetua nga matja e të njëjtës nga ana e MPN-së, e cila ishte 16°C, që është nën standardet e dëshiruara të pranueshme.

Nga inspektimi i realizuar në ambientet për ndalim MPN-ja konstatoi se të njëjtat janë të pajisura në mënyrë përkatëse me mjete të rregulluara dhe të pastra për pushim (për mbajtje afatshkurte dhe gjatë natës). Muret janë të lyera dhe të pastra, por në disa vende dukshëm të dëmtuara. Nën shkallët, pranë hyrjes në pjesën e ambienteve për ndalim gjendet ambienti i cili është i rrethuar me grila dhe i dedikuar për magazinë për ruajtjen e materialeve dhe pajisjeve zyrtare, por prezenca e dy

karrigeve prej druri dhe mungesa e konstatuar e materialit i cili ruhet, tregon përdorimin e mundshëm të ambientit për ndalim të personave.

Në ambientet për ndalim është vendosur video-sistemi (kamera) i cili gjatë kohës së vizitës ishte në funksion. Gjithashtu në këto ambiente ekziston sistemi i instaluar për thirrje i cili nuk është në përdorim. Problemi me mosfunksionimin e sistemit për thirrje ishte konstatuar qysh gjatë vizitës së parë në vitin 2011, ndërsa më datën 08.03.2012 është marrë përgjigjja nga stacioni policor se është dërguar kërkesë pranë SPB-Shkup për riparimin e sistemit për thirrje. Në vitin 2012 MPN-ja ka konstatuar gjendje të njëjtë, përkatësisht është vërtetuar se pjesërisht funksionojnë alarmet, ndërkaq që atëherë nëpunësit policorë kryejnë kontroll të drejtpërdrejtë ndaj personave të ndalur.

Nga inspektimi në evidencën u konstatua se ekzistojnë parregullsi të caktuara gjatë evidentimit të kohës së privimit nga liria dhe kohës së ndalimit të personit, përkatësisht procesverbalet për ndalim jo çdo kund kanë rrjedhë logjike të ngjarjeve me të cilat në mënyrë të saktë do të përcaktohet koha e arrestimit, ndalimit dhe udhëzimit për të drejtat gjatë kohës së ndaljes në stacionin policor.

Gjithashtu u konstatua arrestimi i fëmijës me qëllim të identifikimit të tij, që mund të shkaktojë trauma plotësuese dhe t'i shkelë të drejtat e fëmijëve konform Ligjit për të drejtat e fëmijëve, si dhe evidentimi i personave të njëjtë në librin për persona të arrestuar dhe librin për persona të cilët janë privuar nga liria dhe persona të ndalur.

Si rezultat i vizitës së realizuar Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional përgatiti raport të veçantë në të cilin vuri në dukje gjendje pozitive dhe negative dhe dha rekomandime përkatëse të adresuara pranë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pranë kryeshefit të Stacionit policor Kisella Vodë me qëllim të shmangies së mangësive të identifikuar.